



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ**  
**SEKTORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR**

**Projekt-Vendim - NR. 5**

**Për "Dhënien e Ndhmës Financiare për familjet në nevojë"**

Në mbështetje të ligjit nr.139 /2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar , të nenit 8 pika 2 , nenit 9 nënpika 1.1, gërma "b",ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë". Në bazë të kërkesave të bëra nga familjet e mëposhtme dhe verifikimeve të bëra nga punonjësit socialë të Njërive Administrative të Bashkisë Maliq për gjëndjen social-ekonomike për familjet e mëposhtme i kërkojmë Këshillit të Bashkisë


I. Miratim fondi për familjen e mëposhtme:

Nr	Emri Mbiemri	Nj.Administrative	Shuma /Lekë
1	Ladimir Pashollari	Gorë	40 000
2	Major Rexho	Maliq	20 000
3	Bledar Çeçi	Pirg	30 000
			90 000


II. Fondet do të përballohen nga Buxheti i vitit 2024, si më poshtë :

Gr.	kap	Kod. Prog.	Llog.eko	Emert.Llogarise	Vlera në lekë
00	05	01110	606	Fondi Social	90 000

III. Bashkëngjitur projekt-vendimit relacionin me gjëndjen Social–Ekonomike të familjes.

Konceptoi:	(EmërMbiemër)	Nënshkrimi	Data
Pranoi: Pergi. Sekt.Sherimit Social	A.Lenja		Dt.20.05.2024
Miratoi:Dr.Finances dhe Buxhetit	E.Petrifi		Dt.20.05.2024
Jurist:	A.Muka		Dt 20.05.2024
	J.Thomo		Dt 20.05.2024

**KRYETARI I BASHKISË**  
**Gëzim Topçiu**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

SEKTOR I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

Maliq, më 20.05.2024

Relacion

Për "Dhënien e Ndhmës Financiare për familjet në nevojë"

Në mbështetje të ligjit nr .139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligji nr 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë". Në bazë të verifikimeve të bëra nga punonjësit e Ndhmës Ekonomike Maliq, të Njësive të Bashkisë Maliq për gjendjen social-ekonomike të familjeve të mëposhtme rezultoi se:

**1. Z. Ladimir Pashollari**

Familja e Z. Ladimir Pashollari jeton në kushte shumë të vështira ekonomike. Të ardhurat e vetme të familjes sigurohen nga pensioni i kryefamiljarit Ai jeton vetëm me bashkëshorten. Banesa e ku jeton çifti I të moshuarëve është në kushte shumë të vështira, pasi të ardhurat që ka familja nuk janë të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve. Familja jeton në një zonë të thellë malore dhe kjo e përkeqëson së tepërmi kushtet ekonomike të familjes. Gjithashtu kryefamiljari është dhe i sëmurë , dhe për disa kohë nuk ka mundur të punojë dhe të sigurojë të ardhura për këtë arsye kërkon një ndihmë financiare.

**2. Z. Major Rexho**

Familja e Z.Major Rexho përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët jetonë në Qytetin Maliq ,Bashkia Maliq. Ata jetojnë në kushte të vështira social-ekonomike dhe banesa ku jetojnë është mjaft e amortizuar dhe e ardhura e vetme është pagesa e ndihmës ekonomike të djalit dhe pensionet e të moshuarit. Të ardhurat e tyre janë të pamjaftueshme pasi Z.Major vuan nga Hemiplegji dextra, me sëmundje të tjera bashkëshoqëruese, dhe ka nevojë për mjekime të cilat kushtojnë. Duke njohur situatën e vështirë në të cilën ndodhet familja, është e pamundur që shuma e siguruar nga pensionet të mjaftojë për mbulimin e shpenzimeve për arsye i drejtohet Këshillit Bashkiak për ndihmë financiare.

**3. Z. Bledar Nevrus Çeçi**

Familja e z.Bledar Nevrus Çeçi banorjnë në fshatin Gurishtë, Njësia Administrative Pirq, Bashkia Maliq. Familje është e përbërë nga 6 anëtarë. Para disa muajsh kryefamiljari pëson një aksident të rëndë automobilistik I cili e lë me pasoja të rënda për shëndetin. Ai ka pasur një trajtim të gjatë në QSUT dhe nga diagnoza rezulton të jetë në gjendje të rënduar shëndetësore ku ka nevojë të vazhdueshme për mjekime,terapi dhe kujdes nga një person.

Nevoja për të kërkuar një ndihmë financiare nga Këshilli i Bashkisë Maliq ,vjen pikërisht nga shpenzimet e shumta që ka pasur dhe vazhdon të ketë kjo famije , gjatë ketyre muajëve, ku edhe nëna e Bledarit rezulton të jetë në gjendje shumë të rëndë shëndetësore

Konceptoi:  
Pranoi: Pergi. Sekt.Sherimit Social

A.Lenja  
E.Petriti

Dt.25.03.2024  
Dt.25.03.2024

KRYETARIL BASHKISË

Gëzim Topciu

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë

Tel. & Fax. 0861 2 2026

